

VENDIM
Nr.235, datë 23.3.2011

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, TË BASHKISË SARANDË, TË SIPËRFAQES 9200 M²,
NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.206 “REZIDENCA QEVERTARE
SARANDË”, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1058, DATË 16.7.2008 “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE”,
TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.20, DATË 9.1.2008
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË
PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SARANDË TË QARKUT TË VLORËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të neneve 3, 7, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë Sarandë, të qarkut të Vlorës, të sipërfaqes 9200 (nëntë mijë e dyqind) m² nga trualli funksional i pronës nr.206, me emërtim “Rezidenca qeveritare Sarandë”, sipas studimit pjesor urbanistik bashkël